



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered		08-06-2021		viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SUMSHACK 2964/2021			113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.317/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 29/04/2021 me numër A.nr.317/2021, e parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Garibaldi" 3/12, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "avancim në karrierë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08/06/2021, mori këtë::

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.317/2021 e datës 29/04/2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas Akt emërimit me numër të protokollit 60/2019 të datës 02/05/2019 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare për Regjistrimin e OJQ-ve", e cila me datë 26/05/2020 ka parashtruar kërkesën me numër të referencës 23 tek U.d. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike kërkesën për avancim, e cila kërkon që ti mundësohet ngritja e koeficientit nga 7 në 8, pasi që janë bërë tri vite pune pas diplomimit dhe po ashtu arsyeja e parashtrimt të kërkesës është se: "të gjitha punët në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës që unë i kryej janë të njëjta me koleget/ët në Departamentin ku të cilët janë më koeficient 8".

Pasi që ankuesja nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj të datës 26/05/2020 me numër të referencës 23, me datë 29/04/2021 me numër të protokollit 2076/2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor për ngritje të koeficientit nga 7 në 8 dhe kërkon kompensimin e pagave që nga viti i kaluar ndërsa me datë 07/05/2021 Këshilli kërkon nga ankuesja që të

bëjë plotësimin e ankesës dhe me datë 14/05/2021 me numër të protokollit 2405/2021 ankuesja bënë plotësimin e ankesës që kërkon nga Këshilli që t'i ndihmoj në realizimin e kërkesës për mbajtje të konkursit të brendshëm për ngritje të koeficientit

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06/05/2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 11/05/2021 Ministria e Punëve të Brendshme ka kthyer përgjigje në ankesën e ankueses duke i bashkangjitur edhe shkresat e lëndës faqe 1/12.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Plotësimin e ankesës së datës 14.05.2021 nga ankuesja; Kërkesa e datës 07.05.2021 për plotësim të ankesës; Ankesa e ankueses e datës 29.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për avancim e datës 26.05.2020; Akt emërimi i datës 13.12.2011; Akt emërimi i datës 02.05.2019; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 15.12.2008; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 28.12.2006; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 17.12.2003; Certifikatë e datës 11.07.2017; Diploma e datës 11.07.2017; Cisco e datës 30.09.2009; Certifikatë e datës 21.12.2005; Certifikatë e datës 11.11.2005; Certifikatë e datës 09.02.2006; Diploma e datës 24.05.2001; Kartela e nëpunësit; Vendimi i datës 12.03.2008 për avancim; Kërkesa e datës 29.02.2008 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila kërkon që ti ngritet koeficienti dhe pozita dhe e cila vazhdimisht ka bërë kërkesa për avancim, ndërsa Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar nga provat e lëndës edhe nga vetë ankesa e ankueses se kërkesën e fundit për avancim e ka bërë më datë 26/05/2020 tek U.d Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja çasi që ka bërë kërkesën për avancim më datë 26.05.2020 tek U.d. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe nuk ka marrë përgjigje ka qenë dashtë që kundër heshtjes së kërkesës së saj të datës 26.05.2020 së U.d. Sekretares të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të parashtroj ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në organin e punësimit në pajtim me dispozitat ligjore të nenin 127 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku është përcaktuar se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, fillimisht ankuesja është dashtë që ti shtjerr mjetet e brendshme juridike e pastaj të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ashtu siç është e përcaktuar në dispozitat ligjore të nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që: *"2. Procedurat për*



zgjdhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjdhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrë", andaj ankesa e ankueses e datës 29.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2076/2021 është e parakohshme sepse ankuesja nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme juridike për realizim të së drejtës së saj kundër heshtjes së kërkesës së saj të datës 26.05.2020 kur kemi parasysh faktin se në kohën e parashtrimit të kërkesës së datës 26.05.2020 ka qenë ende në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar shkresat e lëndës ka vërejtur se me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nga ana e ankueses dhe plotësimi të formularit të regjistrimit të ankesës nga ana e zyrtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është bërë një gabim teknik sa i përket datës së parashtrimit të ankesës sepse realisht ankesa në Këshill është parashtruar me datë 29/04/2021 me numër të protokollit 2076/2021 ndërsa në formular është shkruar data 28/04/2021 andaj afati për vendosje të ankesës është llogaritur nga data 29/04/2021.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.317/2021, datë 08/06/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.